



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

VENDIM

K.P.P. 589/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04.09.2019, shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës të BOE “Doksani - G” sh.p.k. & “Varaku E” sh.p.k., në procedurën e prokurimit, “*Kërkesë për propozim*”, me nr. REF-20995-05-08-2019, me objekt: “*Riparim dhe ndriçim trotuaresh në unazën e vogël Shijak*”, me fond limit 6,166,249 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 20.05.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shijak.
- Ankimues:** Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Doksani-G” sh.p.k. & “Varaku E” sh.p.k.
Adresa: Lagjia “Popullore”, Shijak
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Shijak
Adresa: Lagjia “Erzen”, Shijak
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës dhe të dokumentacionit të dërguar nga operatori ekonomik ankimues dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, operatori ekonomik ankimues kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.3. Ankimesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 09.05.2019, në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit, “*Kërkesë për propozim*”, me nr. REF-20995-05-08-2019, me objekt: “*Riparim dhe ndriçim trotuaresh në unazën e vogël Shijak*”, me fond limit 6,166,249 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 20.05.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shijak.

II.2. Në datën 20.05.2019, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 12.06.2019, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- | | |
|---|-------------------------------|
| 1. “Meni” sh.p.k. | 3,473,309 lekë, Skualifikuar; |
| 2. “Ina” sh.p.k. | 3,635,520 lekë, Skualifikuar; |
| 3. ”Doksani - G” sh.p.k. & ”Varaku E” sh.p.k. | 4,104,080 lekë, Skualifikuar; |
| 4. “Hysi – 2F” sh.p.k. | 4,478,750 lekë, Skualifikuar; |
| 5. “Sark” sh.p.k. | 4,616,310 lekë, Skualifikuar; |
| 6. “Liqeni VII” sh.a. | 4,669,325 lekë, Kualifikuar; |
| 7. “K.M.K” sh.p.k. | 4,711,600 lekë, Skualifikuar; |
| 8. “Spektri” sh.p.k. | 4,914,880 lekë, Kualifikuar; |
| 9. “Shëndelli” sh.p.k. | 4,997,590 lekë, Skualifikuar; |
| 10. “Al - Asfalt” sh.p.k. | 5,373,050 lekë, Kualifikuar; |
| 11. “Kupa” sh.p.k. | 5,640,880 lekë, Skualifikuar; |

II.4. Me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), autoriteti kontraktor ka njoftuar BOE “Doksani - G” sh.p.k. & “Varaku E” sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tij, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, me arsyetimin si më poshtë vijon:

“- BOE nuk plotëson kapacitetin teknik sipas pikës 2.2 të DST: 1. Mungon 1 (një) automakinist i pajisur me leje drejtimi nga DPSHTRR”

II.5. Në datën 13.06.2019, BOE “Doksani - G” sh.p.k. & “Varaku E” sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“[...]Nga ana jone si Bashkim Operatoresh ne permbushje te ketij kriteri kemi paraqitur Automakinistin B. A. V. (i shoqerise Varaku sh.p.k) i cili eshte i pajsur me “Leje manovrimi per Automakinist” i leshuar nga organi shteteror i autorizuar ne kohen qe e ka marre, automakinisti B. V., konkretisht kjo deshmi eshte e ligjeruar nga Ministria e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit si dhe Shoqata e Ndertueve te Shqiperise. Nga ana juaj ne asnje moment nga ana juaj ne DST nuk eshte kerkuar qe Deshmia e Drejtimit te ishte leshuar nga DPSHTRR dhe per kete shkak vendimarrja juaj eshte eshte haptazi e paligjshme dhe abuzive.

Ne rastin konkret nuk eshte percaktuar ne asnje moment se Deshmia te jete leshuar nga DPSHTRR dhe se Leja e Automakinistit B. V. eshte plotesisht e ligjshme e leshuar nga autoritetet ligjore te ngarkuara me ligj per leshimin e tyre ne kohen e marrjes se kesaj Leje, e cila ka afat vlefshmerie nje afat te pacaktuar.

Ritheksojme se vlerësimi i ofertave referuar kriterëve të tjera të kualifikimit të cilat në asnjë rast nuk janë parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm që është në kundërshtim me nenin 55 pika 2 e LPP-së, i cili parashikon se “Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderi.”, por çënon gjithashtu parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, parashikuar nga neni 2 i lex specialis, atë të barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve që i ngarkohen ofertuesve. [...]”

II.6. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 2017/2 Prot. datë 19.06.2019, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje BOE “Doksani - G” sh.p.k. & “Varaku E” sh.p.k., duke mos e pranuar ankesën e paraqitur prej tij, me argumentimin si më poshtë vijon:

”[...] Në lidhje me këtë pretendim sqarojmë se : Në Dokumentat Standarte të Tenderit për procedurën "Riparim dhe ndriçim trotuaresh në unazën e vogël, Shijak ", në piken 2.2 “Kapacitete Teknike” ndër të tjera është kërkuar: Ofertuesi duhet të ketë të punësuar si dhe të përfshirë në listepagesat e shoqërisë: 2 (dy) Eskavatorist dhe 1 (një) Automakinist, për të cilët duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmitë e drejtimit të vlefshme, lëshuar nga institucionet përkatëse . Pavarësisht se në DST sikundër pretendoni edhe ju nuk është kërkuar që dëshmia e drejtimit të jetë lëshuar nga DPSHTRR:

1. Është cituar që dëshmia duhet të jetë lëshuar nga institucionet përkatëse dhe bazuar në Urdhrin e Ministrisë të Punëve Publike nr. 109, datë 05.08.2013 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit” institucioni përkatës për lëshimin e dëshmive të drejtimit të makinerive të rënda është DPSHTRR.

Konkretisht neni 3, pika 3, gërma “e” e Urdhrit të lartëpërmendur parashikon shprehimisht se “Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor” (DPSHTRR) është organi që jep dëshminë e aftësisë profesionale (DAP), në përputhje me përcaktimet e pikës 3 a dhe 3 b të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 808, datë 4.12.2003, të ndryshuar”.

2. Ky kriter është kuptuar qartë (nuk ka krijuar konfuzion) nga ana juaj duke qenë se për eskavatoristët keni paraqitur dëshmi drejtimi të lëshuar nga DPSHTRR.

Referuar nenit 13/2 dhe 13/3 të Urdhrit të lartëpërmendur që parashikon shprehimisht se :

“2. Dëshmia e aftësisë profesionale lëshohet në përputhje me modelin e paraqitur nga DPSHTRR-ja dhe e miratuar nga ministria që mbulon transportin.

3. Dëshmia e aftësisë profesionale është e vlefshme me afat 5-vjeçar, nga data e lëshimit dhe shfrytëzohet vetëm për ato qëllime për të cilat ajo është lëshuar” dhe duke qenë se dëshmia e drejtimit të automakinistit B. V.: 1. është lëshuar nga Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë dhe jo nga organi kompetent i njohur nga legjislacioni në fuqi, konkretisht DPSHTRR. 2. është lëshuar në vitin 2006 dhe i ka mbaruar afati i vlefshmërisë, prej 5 vjetësh, që parashikon legjislacioni në fuqi pretendimi juaj nuk qëndron dhe nuk merret paraqysh. [...]”

II.7. Në datën 25.06.2019, BOE “Doksani - G” sh.p.k. & “Varaku E” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“[...]Nga ana jone si Bashkim Operatoresh ne permbushje te ketij kriteri kemi paraqitur Automakinistin B. Ali V. (i shoqerise Varaku sh.p.k) i cili eshte i pajsur me “Leje manovrimi per Automakinist” i leshuar nga organi shteteror i autorizuar ne kohen qe e ka marre automakinisti B. V., konkretisht kjo deshmi eshte e ligjeruar nga Ministria e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit si dhe Shoqata e Ndertueve te Shqiperise. Nga ana e Autoritetit Kontraktor ne DST ne asnje moment nuk eshte kerkuar qe Deshmia e Drejtimit per Automakinist te ishte leshuar nga DPSHT/RR dhe per kete shkak vendimarrja e KVO prane Bashkise Shijak eshte haptazi e paligjshme dhe abuzive.

Nga ana e Autoritetit Kontraktor ne pergjigje te ankimit tone, ka arsyetuar nder te tjera se:

...Ne DST... eshte cituar qe deshmi duhet te jete leshuar nga institucionet peraktese dhe bazuar ne Udhezimin e Ministrit te Puneve Publike Nr. 109 date 05.08.2013 “Për miratimin e rregullores“ për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të candidateve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”, institucioni perkates per leshimin e deshmieve te drejtimit te makinerive te renda eshte DPSHTRR.... konkretisht neni 3... neni 13/2 dhe neni 13/3, dhe ndodhur perpara ketij arsyetimi ligjore AK Bashkia Shijak nuk njeh deshmine e automakinistit B. V. te leshuar nga Shoqata e Ndertuesve te Shqiperise dhe nga Ministria e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit ne vitin 2006.

Te Nderuar Anetare te Komisionit te Prokurimit Publik! Arsyetimi qe ben Autoriteti Kontraktor eshte ne kundërshtim me vete dispozitat urdheruese te udhezimit per shkak se Udhezimi qe permend AK Bashkia Shijak, ka perjashtuar nga pajisja “Rinovimi” i lejeve per Automakinistet, per shkak se Leja e leshuar nga Shoqata e Ndertuesve te Shqiperise dhe nga Ministria e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit eshte leshuar pa afat.

Vlen te theksojme per analogji sanksionimet e bera ne nenin 14 te Udhezimit 109/2013: Kur mbajtësi i një dëshmie të aftësisë profesionale (DAP) kërkon rinovimin e dëshmisë kur është mbushur afati i vlefshmërisë, duhet të bëjë një kërkesë me shkrim në sektorin përkatës të DPSHTRR-së dhe të shoqëruar me dëshminë origjinale.

Në të gjitha rastet, dëshmitë e aftësisë profesionale të lëshuara nga Ministria e Bujqësisë, Ministria e Ndërtimit, Shoqata Kombëtare e Ndërtuesve apo dhe nga çdo institucion tjetër i autorizuar para datës 23.3.2012, do të pranohen të rinovohen vetëm nëse i interesuari do të paraqesë në origjinal dëshminë që disponon.

Ne rastin konkret automakinisti i Shoqërisë ka një dëshmi që nuk kërkon rinovim për shkak se nuk ka afat vlefshmerie, për vetë profesionin si Automakinist. Baza ligjore e përdorur nga AK Bashkia Shijak për nenet 3,13/2,13/3 të Udhëzimit 109/2013 nuk gjen mbështetje për shkak se këto nene zbatohen për ata persona që pajisen për herë të parë me dëshmi të aftësisë profesionale (DAP) dhe jo për ata persona që janë të pajisur tashme me leje. (Thëksojmë se ligji nuk mund të ketë fuqi prapavepruese).

Ne rastin konkret nuk është përcaktuar në asnjë moment që Dëshmia të jetë lëshuar nëa DPSHTRR dhe se Leja e Automakinistit B. V. është plotësisht e ligjshme e lëshuar nga Autoritetet ligjore të ngarkuara me ligj për lëshimin e tyre në kohën e marrjes së kësaj Leje e cila ka afat vlefshmerie një afat të pacaktuar. Rithëksojmë se vlerësimi i ofertave referuar kritereve të tjera të kualifikimit të cilat në asnjë rast nuk janë parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm që është në kundërshtim me nenin 55 pika 2 e LPP-së, i cili parashikon se “Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.”, por çënon gjithashtu parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, parashikuar nga neni 2 i lex specialis, atë të barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve që i ngarkohen ofertuesve. [...]”

II.8. Në datën 10.07.2019, me anë të shkresës nr.2296/1prot., datë 05.07.2019, ka mbërritur pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni i autoritetit kontraktor në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.9. Në datën 19.08.2019, me shkresën nr. 1155/4 prot., Komisioni i Prokurimit Publik, i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, për informacion dhe sqarim në lidhje me vlefshmërinë e dëshmimeve të aftësisë profesionale (Leje manovrimi) të lëshuar nga Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë dhe konkretisht lidhur me statusin e vlefshmërisë së lejes së manovrimit nr.419.

II.10. Në datën 27.08.2019 dhe datë 30.08.2019 janë protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, shkresat nr. 17607/1 prot., datë 26.08.2019 dhe nr. 17607/2 prot., datë 29.08.2019 e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, e cila, sqaron se:

[...]

Në bazë të VKM 736, datë 01.07.2009, për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin Nr. 808 datë 04.12.2003 “Për dhënien e lejeve të manovrimit përdoruesve të makinerive të rënda të ndërtimit”, ngarkohet DPSHTRR për pajisjen me Dëshmi Aftësie Profesionale të përdoruesve të makinerive të rënda.

Në bazë të Urdhërit nr. 200, datë 16.05.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teorike – praktike të kandidatëve si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit” dhe pas plotësimit të kriterëve ligjore nga të interesuarit, kryejmë shërbim për pajisje dhe rinovim për këto lloj dëshmish.

Në rastet e pajisjes për herë të parë nga DPSHTRR rastet e rinovimeve të tyre, për përfundim të afatit, rastet e humbjes apo dëmtimit për dëshmi të lëshuara nga institucionet e legjitimuara përpara datës 01.07.2019 për rastin konkret lëshuar nga Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë.

Sa më sipër sqarohet se DPSHTRR disponon një pjesë të arshivës së Shoqatës së Ndërtuesve, në të cilën përpara çdo veprimi administrativ në lidhje me dëshminë bëhen verifikimet në lidhje me të dhënat e saj në regjistrat përkatës. Leja e manovrimit bashkëngjitur shkresës suaj, nuk është e pasqyruar në arshiven e sipërpërmendur. Për verifikimin dhe konfirmimin e vlefshmërisë së lejes së manovrimit në emër të z. B.V. sugjerojmë ti drejtoheni Shoqatës së Ndërtuesve të Shqipërisë.

[...]

Në bazë të Urdhërit nr. 200 datë 16.05.2019, neni 15 Rinovimi i DAP:

Dëshmia e Aftësisë Profesionale është në origjinal dhe pretendohet se është lëshuar nga Shoqata Kombëtare e Ndërtuesve por nuk figuron në praktikat protokollare të kësaj shoqate të dorëzuar në DPSHTRR i interesuari duhet të paraqesë një vërtetim zyrtar, nga subjekti apo institucioni që e ka lëshuar, në të cilin të përmendet lloji i dëshmisë, numri i protokollit dhe data e lëshimit të saj si dhe kopje e librezës së punës të legalizuar, ku është shënuar profesioni për të cilin kërkohet shërbimi.

Të gjitha dëshmitë e lëshuara para vitit 2010 nga institucione të tjera të legjitimuara dhe paraqiten në origjinal pranë DPSHTRR për rinovim si dhe figurojnë në praktikat protokollare që ne disponojmë i konsiderojmë të vlefshme.

II.11. Në datën 19.08.2019, me shkresën nr. 1155/6 prot., Komisioni i Prokurimit Publik, i është drejtuar Shoqatës së Ndërtuesve të Shqipërisë, për informacion dhe sqarim në lidhje me statusin e vlefshmërisë së lejes së manovrimit nr. 419.

II.12. Në datën 02.09.2019 është protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, shkresa nr. 3262 prot., datë 29.08.2019 e Shoqatës së Ndërtuesve të Shqipërisë, e cila, sqaron se:

[...]

Ju informojmë se në bazë të dokumentave që ka Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë, leja e manovrimit me nr. 419 që është lëshuar në datën 08.02.2006, nuk i përket B.V. por një personi tjetër.

Leja e manovrimit që na paraqitni është e pavlefshme.

Do të ishte e vlefshme Leja e manovrimit e rinovuar mba vitit 2009 pranë DPSHTRR që është institucioni i ngarkuar për këtë qëllim.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor, si dhe dokumentacionit të administruar,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Doksani - G” sh.p.k. & “Varaku E” sh.p.k., se arsyeja e skualifikimit të ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi “- BOE nuk plotëson kapacitetin teknik sipas pikës 2.2 të DST: 1. Mungon 1 (një) automakinist i pajisur me leje drejtimi nga DPSHTRR”, nuk qëndron, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit shtojca 11, pika 2.2. Kapaciteti teknik, nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar kriteri: *“Ofertuesi duhet të ketë të punësuar si dhe të përfshirë në listepagesat e shoqërisë:*

- *2 (dy) Eskavatorist, dhe 1 (nje) Automakinist, për të cilët duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmitë e drejtimit të vlefshme, lëshuar nga institucionet përkatëse .*
- *2 (dy) Elektriçist për të cilët duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme dhe dëshmi aftësie e lëshuar nga subjekte të akredituar për certifikimin e punonjësve.*
- *2 (dy) Karpentierë për të cilët duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme dhe dëshmi aftësie e lëshuar nga subjekte të akredituar për certifikimin e punonjësve.*

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë ”Doksani - G” sh.p.k. & ”Varaku E” sh.p.k., rezulton se, është paraqitur dokumenti me emërtimin Kontratë bashkëpunimi të përkohshëm të shoqërive ndërmjet shoqërisë ”Doksani - G” sh.p.k. & ”Varaku E” sh.p.k. nga ku shoqëria “Doksani - G” sh.p.k. merr përsipër për realizimin e objektit të mësipërm në masën 55% dhe ” Varaku E” sh.p.k. merr përsipër në masën 45% referuar preventivit të përcaktuar në kontratën e bashkëpunimit.

Gjithashtu është paraqitur edhe dokumenti Prokurë e Posaçme, sipas së cilës shoqëria “Doksani - G” sh.p.k. është përfaqësuese e këtij bashkimi operatorësh ekonomikë.

III.1.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, rezulton se është paraqitur, në përmbushje të kriterit të sipërcituar si më poshtë vijon:

- Shoqëria “Varaku E” sh.p.k. ka paraqitur dokumentin leje manovrimi për automakinist për punonjësin B.V, të lëshuar nga Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë më 08.08.2006, me nr. 419; librezë punë; kontratë pune.
- Shoqëria «Doksani – G » sh.p.k. nuk ka paraqitur dokumentacion në lidhje me stafin automakinist.

III.1.4. Në nenin 46, pika 1 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.*

III.1.5. Në nenin 53, pika 3 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.*

III.1.6. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26, pika 8, parashikohet si më poshtë: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:*

- a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;dhe/ose*
- b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomikë nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;dhe/ose*
- c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.*

III.1.7. Referuar legjisllacionit në fuqi për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të

vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës në respekt të nenit 46 pika 1 gërma “b”, të Ligjit Nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parashikon se: “[...] aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës [...]”.

III.1.8. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes KPP kërkoi informacion pranë organeve përkatëse kompetente dhe bëri verifikimet e duhura duke iu drejtuar këtyre organeve, me qëllim shqyrtimin sa më të drejtë të ankesës së paraqitur, për arsye se legjislacioni në lidhje me këto leje ka pësuar ndryshime.

Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë, e cila ka lëshuar këtë dokument, informon se (citojmë):

“Ju informojmë se në bazë të dokumentave që ka Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë, leja e manovrimit me nr. 419 që është lëshuar në datën 08.02.2006, nuk i përket B.V. por një personi tjetër.

Leja e manovrimit që na paraqitni është e pavlefshme.

Do të ishte e vlefshme Leja e manovrimit e rinovuar mbas vitit 2009 pranë DPSHTRR që është institucioni i ngarkuar për këtë qëllim”.

Sa më sipër, referuar informacionit dhe dokumentacionit të administruar për këtë procedurë prokurimi, nga verifikimet pranë organeve përkatëse që kanë lëshuar këtë dokument, konstatohet se leja e manovrimit nr. 419 e lëshuar në emër të z. B.V. është e pavlefshme dhe nuk konsiderohet e saktë e në përputhje me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

III.1.9. Në Kreun VIII, neni 74, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi”.*

Në Kreun VIII, neni 74, pika 2 po këtu, parashikohet: *“Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi...”,* ndërsa në pikën 3 parashikohet: *“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.*

III.1.10. Sqarojmë se, referuar rregullave të prokurimit publik, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor, duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e shërbimeve të marra përsipër.

III.1.11. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “ Doksani - G” sh.p.k. & ”Varaku E” sh.p.k., nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, për mjetet, për shkak të mangësive të evidentuara më sipër.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit.

Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

III.1.12. Operatori ekonomik ankimues duhet të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve para hapjes së ofertave.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.

Në rastin konkret, dokumentacioni i paraqitur nga ana e ankimuesit në këtë procedurë prokurimi, objekt shqyrtimi, nuk është i rregullt dhe për shkak të mangësive që ka nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe si i tillë konsiderohet i pavlefshëm.

III.1.13. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, në rast se, operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP.

Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”*.

Gjithashtu, kuadri ligjor, parashikon një sërë elementësh, si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese.

Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së.

Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave.

Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...].”

Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, bashkimi i operatorëve ekonomikë ”Doksani - G” sh.p.k. & “Varaku E” sh.p.k. nuk e përmbush kriterin e përcaktuar në shtojcën 11 të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion për stafin e kërkuar në dokumentat e tenderit.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Nga verifikimet e kryera, në lidhje me lejen e manovrimit të paraqitur nga ana e operatorit ekonomik ankimues, konstatohet se Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor informon se *“Leja e manovrimit bashkëngjitur shkresës suaj, nuk është e pasqyruar në arshiven e sipërpërmendur. Për verifikimin dhe konfirmimin e vlefshmërisë së lejes së manovrimit në emër të z. B.V. sugjerojmë ti drejtoheni Shoqatës së Ndërtuesve të Shqipërisë”,* ndërsa Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë, e cila ka lëshuar këtë dokument, i cili ka qenë edhe arsyeja e skualifikimit, informon se (citojmë):

“Ju informojmë se në bazë të dokumentave që ka Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë, leja e manovrimit me nr. 419 që është lëshuar në datën 08.02.2006, nuk i përket B.V. por një personi tjetër”.

Referuar informacionit të Shoqatës së Ndërtuesve të Shqipërisë me shkresën nr. 3262 prot., datë 29.08.2019, të depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1155/8 prot., datë 02.09.2019, duke qenë se, konstatohet se leja e manovrimit me nr. 419 që është lëshuar në datën 08.02.2006, nuk i përket B.V., por një personi tjetër, në lidhje me dokumentacionin e operatorit ekonomik ankimues, rekomandojmë që, Agjencia e Prokurimit Publik, në bazë të përcaktimeve të nenit 13 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të kryejë hetimet përkatëse për dokumentacionin e mësipërm.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Doksani - G” sh.p.k. & “Varaku E” sh.p.k., për procedurën e prokurimit *“Kërkesë për propozim”,* me nr. REF-20995-05-08-2019, me objekt: *“Riparim dhe ndriçim trotuaresh në unazën e vogël Shijak”,* me fond limit 6,166,249 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 20.05.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shijak.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
3. T'i propozojë Agjencisë së Prokurimit Publik, nisjen e hetimit administrativ në lidhje me konstatimet e mësipërme.
4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1155 protokoli

Datë 25.06.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha